



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:000905
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728717

C.nr.5/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti Përgjithshëm gjyqtari Agron karatash, me zyrtaren ligjore I.R. në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.C. nga fsh. Komuna e Dragaashit të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës KS Kosova e Re me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me datën 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Procedura në këtë çështje juridike kontestimore **NDËRPRITET**, për shkak të falimentimit të KS Kosova e Re me seli në Prishtinë.

II.Procedura e ndërprerë eventualisht do të vazhdoj kur administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marin përsipër procedurën

A r s y e t i m

Paditësja A.C. përmes të autorizuarit të saj pranë kësaj gjykate me datë 06.01.2021 ka paraqitur padi për kompensim dëmi, , kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro

Me datën 17.05.2024, e autorizuar e paditëses F.S. në seancën e shqyrtimit përgaditor e njofton gjykatën se ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” , është filluar procedura e falimentimit dhe ka kërkuar nga gjykata që kjo çështje kontestimore të ndërpritet.

Pasi që ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re ” është filluar procedura e falimentimit, në kuptim të nenit 277 par.1germa (d) lidhur me nenin 280 paragrafi 1 të LPK-së, e ndërpreu procedurën duke i udhëzuar palët për mënyrën e vazhdimit të procedurë.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PËR ÇËSHTJE CIVILE**

2021:000905, 23.05.2024

G j y q t a r i

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.